



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokuroria kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Veld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti, Gjykatës Raportues

Gjykatës Vladimir Mikula, Gjykatës Rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 maj 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Julius von Bóné

Zyrës Administrative

Shefes së Zyrës së Pjesëmarrjes së
Viktimave

Mbrojtëses së viktimave

Ani Pues

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues),¹ në pajtim me nenin 22(9) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullën 167 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.²

2. Në këtë çështje gjyqësore, ZPS-ja pretendon se Salih Mustafa, së bashku me anëtarë të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), kryen krime lufte kundër personave të cilët ata i ndaluan dhe i akuzuan se kishin bashkëpunuar me autoritetet serbe dhe se nuk përkrahën UÇK-në.³

3. Më 30 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin e Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”, duke pranuar pesë viktima për pjesëmarrje në këtë çështje dhe udhëzoi Administratoren që, deri të premten, 7 maj 2021, të caktojë mbrojtësin e viktimave për viktimat e përfaqësuara si Grupi 1.⁴

¹ KSC-BC-2020-05, F00114, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Trupit Gjykues*, 5 maj 2021, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00011/A02, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë*, 19 qershor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik i Aktakuzës së Konfirmuar u protokollua më 28 shtator 2020 (KSC-BC-2020-05, F00019/A01, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Publik i Aktakuzës* (Versioni i redaktuar publik i Aktakuzës së Konfirmuar, 28 shtator 2020, publik).

³ Versioni i Redaktuar Publik i Aktakuzës së Konfirmuar, para. 29.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00105/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit të Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 30 prill 2021, publik.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Në fjalinë e parë të nenit 22(3) të Ligjit, lexohet se “interesi personal dhe të drejtat e një viktime në procedurën penale para Dhomave të Specializuara janë njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi”.

5. Neni 22(9) i Ligjit dhe rregulla 167 e Rregullores i japin mundësinë Trupit Gjykses që, ku është e përshtatshme, t’i udhëzojë viktimat të ngrenë padi civile në gjykatat e tjera në Kosovë.

6. Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Kushtetuta) deklaron: “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar në këtë Kushtetutë ose me ligj, dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një drejtë e tillë është shkelur.”

7. Neni 22 i Kushtetutës parasheh se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara, ndër të tjera, nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), dhe Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Poshtëruese (KKT), garantohen nga Kushtetuta dhe zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës, dhe në rast mospajtimi kanë përparësi ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

8. KEDNJ-ja dhe KNDCP-ja parashohin të drejtën për gjykim të drejtë dhe mjete juridike efikase (nenet 6(1) dhe 13 të KEDNJ-së dhe 2(3) dhe 14(1) të KNDCP-së). Neni 14 i KKT-së parasheh se “[ç]do shtet palë, në sistemin e vet juridik, garanton zhdëmtimin e viktimave të një akti torture dhe të drejtën e zbatueshme për t’u dëmshpërblyer me drejtësi dhe në mënyrë adekuate, duke përfshirë mjetet për riaftësim sa më të shpejtë. Në rast të vdekjes së viktimës si pasojë e një akti torture, personat në ngarkim financiar të viktimës kanë të drejtë për dëmshpërblim”.

III. ANALIZË

9. Në lidhje me gjykimet në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK), Trupi Gjykses do të bëjë dallimin midis procesit penal *stricto sensu* që lidhet me vendimin mbi akuzat e paraqitura kundër të akuzuarit në Aktakuzën e Konfirmuar, dhe procesit për zhdëmtim që eventualisht mund të rezultojë në lëshimin e një urdhri për zhdëmtim, sikurse përcaktohet në nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

A. FAZA E PROCESIT TË ZHDËMTIMIT SIPAS KORNIZËS LIGJORE TË DHSK-SË

10. Neni 22(7) i Ligjit thotë “[n]ë aktgjykimin e tij, trupi gjykses mundet që, në bazë të një kërkese apo me propozim të vetin në rrethana të jashtëzakonshme, të përfshijë një vendim lidhur me shkallën dhe përmasat e dëmit, humbjes dhe lëndimeve ndaj viktimave, ose në lidhje me to, dhe i deklaron parimet sipas të cilave vepron. Nga ana tjetër, nëse një vendim i tillë do të zvarriste në mënyrë jo të duhur procedurën penale, trupi gjykses mund ta kufizojë vendimin e vet në identifikimin e viktimave të krimeve të vërtetuara në aktgjykimin e vet”. Sipas mendimit të Trupit Gjykses, kjo dispozitë tregon qartë se në qoftë se Trupi Gjykses vendos të lëshojë një vendim lidhur me dëmin, humbjen apo lëndimin e pësuar nga viktima të tilla, dhe lidhur me përcaktimin e parimeve mbi zhdëmtime ndaj atyre viktimave, një vendim i tillë duhet të jetë pjesë e qenësishme e aktgjykimit të cilit i referohet neni 43 i Ligjit.

11. Gjithashtu, neni 22(8) i Ligjit thotë “[k]ur trupi gjykses ose paneli i Gjykatës së Apelit të Dhomave të Specializuara e gjykon të akuzuarin si fajtor për ndonjë krim, ai mund të nxjerrë një urdhër drejtpërdrejt kundër personit të akuzuar, ku specifikon zhdëmtimin e duhur ndaj viktimave, kolektivisht apo individualisht, ose në lidhje me ato viktima”. Gjithashtu, neni 44(6) i Ligjit thotë “[p]ërveç dënimit me burg, Dhomat e Specializuara mund ta urdhërojnë personin e dënuar që ta dëmshpërblejë ose ta kompensojë viktimën apo viktimat bashkërisht, ose mund të urdhërojnë konfiskimin

e pronës, të ardhurave dhe të aseteve që përdoren për kryerjen e krimit dhe që rrjedhin nga kryerja e krimit dhe kthimin e tyre tek pronari i ligjshëm apo shitjen dhe ndarjen midis viktimave sipas nenit 22 (“Urdhri për Zhdëmtim”). Ligji nuk parashikon proces të mëtejshëm para Trupit Gjykes pas vendimit lidhur me dënimin. Neni 46(9) i Ligjit thotë “[G]jykata e Apelit gjithashtu mund të shqyrtojë ankesa kundër ndonjë aktgjykimi të trupit gjykes nga mbrojtësi i viktimave por vetëm në lidhje me vendimin e ndonjë paneli lidhur me statusin e viktimës apo ndonjë urdhër për zhdëmtim. Gjatë procedurës së apelit, viktimat pretenduese përfaqësohen kolektivisht si një grup nga Mbrojtësi i Viktimave i caktuar nga Zyra Administrative”. Sipas mendimit të Trupit Gjykes, këto dispozita tregojnë qartë se çdo urdhër për zhdëmtim duhet gjithashtu të jetë pjesë e aktgjykimit të lëshuar nga Trupi Gjykes.

12. Sa i përket procesit për zhdëmtim, neni 22(3) i Ligjit thotë “[R]regullat e Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuara përfshijnë dispozitat që kanë të bëjnë me zhdëmtimin e arsyeshëm të viktimave nga i akuzuari i cili e ka pranuar fajësinë apo që është gjykuar të jetë fajtor për ndonjë krim (krimet) që kanë rezultuar të jetë drejtpërdrejt i dëmshëm për viktimat”. Në këtë aspekt, rregulla 168 e Rregullores parasheh vetëm se “[n]ë qoftë se trupi gjykes nxjerr një urdhër sipas nenit 22(8) të Ligjit kundër personit të shpallur fajtor, në bazë të një kërkesë të mbrojtësit të viktimave, të personit të shpallur fajtor, ose *proprio motu*, trupi gjykes mund të emërojë ekspertë për ta ndihmuar në përcaktimin e masës së dëmit të shkaktuar viktimave, ose në lidhje me viktimat, dhe për sugjerime në lidhje me zhdëmtimin individual ose kolektiv prej personit të shpallur fajtor. Trupi gjykes mund të ftojë mbrojtësin e viktimave dhe personin e shpallur fajtor që të paraqesin vërejtjet e tyre në lidhje me aktekspertizat.”. Megjithatë, kjo rregull nuk përcakton ndonjë afat konkret për emërimin e ekspertëve, dorëzimin e aktekspertizave të tyre, dhe vërejtjeve të mundshme nga mbrojtësi i viktimave dhe personi i shpallur fajtor, si dhe për lëshimin e vendimit nga Trupi Gjykes pas këtij procesi. Edhe pse i

referohet vërejtjeve nga “personi i shpallur fajtor”, që sugjeron se ato vërejtje duhet të dorëzohen pas lëshimit të vendimit të fajësisë, rregulla nuk parasheh asnjë proces shtesë për vendimin mbi zhdëmtimin e viktimave, pas shpalljes së fajësisë ose pas vendimit të dënimit.

13. Kjo gjithashtu konfirmohet nga dispozita të tjera që përmban Rregullorja. Rregulla 159(5) e Rregullores thotë “[n]ë qoftë se e shpall të akuzuarin fajtor, trupi gjykues mund të nxjerrë urdhra sipas nenit 22(8) deri (11) dhe 44(6) të Ligjit”. Rregulla 173(2) e Rregullores thotë “Mbrojtësi i viktimave mund të apelojë aktgjykimin e trupit gjykues brenda kufijve të nenit 46(9) të Ligjit”. Rregulla 176(2) e Rregullores i referohet vetëm “vendimit të gjykimit” ose “vendimit të dënimit”. Askund në Rregullore nuk parashihet apel ndaj një urdhri për zhdëmtim.

14. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh dispozitat e lartpërmendura, i vetmi përfundim i mundshëm sipas mendimit të Trupit Gjykues, është se urdhri për zhdëmtim duhet lëshuar bashkë me vendimin e gjykimit (në rast të shpalljes së fajësisë) ose, më së voni bashkë me vendimin e dënimit, në qoftë se i akuzuari shpallet fajtor por dënimi nuk shqiptohet në vendimin e gjykimit.

15. Trupi Gjykues është i mendimit se, në rast të udhëzimit për ngritje të padisë civile në gjykata shtetërore të Kosovës, kryerja e njëkohshme e procesit penal dhe procesit për zhdëmtim nuk do të ishte e përshtatshme.

B. PALËT NË PROCES PËR ZHDËMTIM PARA DHSK-SË

16. Rregulla 2(1) e Rregullores përcakton se “përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe”, termi “palë” i referohet “Prokurorit të Specializuar ose Mbrojtjes”. Neni 22 i Ligjit nuk përmend “palët” ose Prokurorin e Specializuar/ZPS-në. Sa u përket atyre që mund të paraqesin parashtrime në procedurën për zhdëmtim, neni 22(11) i Ligjit i referohet “të akuzuarit, viktimave, personave të tjerë të interesuar ose shteteve të

interesuara". Gjithashtu, rregulla 168 e Rregullores, që ka të bëjë me një urdhër eventual zhdëmtimi kundër personit të dënuar, parasheh vetëm personin e dënuar dhe mbrojtësin e viktimave si parashtrues të vërejtjeve. Rrjedhimisht, nuk parashihet as në Ligj e as në Rregullore që Prokurori i Specializuar të jetë palë në procese të tilla. Trupi Gjykues thekson se viktimat përmenden si në nenin 22(11) të Ligjit ashtu edhe në rregullën 168 të Rregullores; gjithashtu, neni 46(9) i Ligjit dhe rregulla 173(2) e Rregullores parashohin se mbrojtësi i viktimave mund të apelojë një vendim të një trupi gjykues lidhur me urdhër për zhdëmtim. Nga çfarë u parashtrua më sipër, del qartë se viktimat duhet të konsiderohen si palë në proceset për zhdëmtim.

17. Sipas mendimit të Trupit Gjykues, duke marrë parasysh dispozitat e lartpërmendura, i vetmi përfundim i mundshëm është se "palët" në kontekstin e proceseve për zhdëmtim duhet të jenë Mbrojtja dhe viktimat, të përfaqësuara nga mbrojtësi për viktima.

C. NEVOJA PËR GARANTIMIN E EFIKASITETIT TË MJETIT JURIDIK NË LIDHJE ME ZHDËMTIMIN E VIKTIMAVE

18. Trupi Gjykues thekson se neni 22(9) i Ligjit nuk përcakton kritere për të vendosur se në cilat rrethana do të ishte e përshtatshme t'i udhëzojë viktimat të ngrenë padi civile në gjykatat e tjera të Kosovës, ose, ndryshe, në pajtim me nenin 22(8) të Ligjit, "[k]ur trupi gjykues ose paneli i Gjykatës së Apelit të Dhomave të Specializuara e gjykon të akuzuarin si fajtor për ndonjë krim", të "nxjerrë urdhër drejtpërdrejt kundër personit të akuzuar, ku e specifikon zhdëmtimin e duhur ndaj viktimave, kolektivisht apo individualisht, ose në lidhje me ata viktima".

19. Trupi Gjykues është i mendimit, se nuk do të ishte e përshtatshme sikurse përmendet në nenin 22(9) të Ligjit, që t'i udhëzojë viktimat të ngrenë padi civile në gjykatat e tjera të Kosovës, pa përcaktuar fillimisht nëse viktimat do të kenë mjete

juridike të përshtatshme në lidhje me kërkesat e tyre për kompensim në përputhje me tekstet juridike përkatëse të përmendura në pjesën II të këtij vendimi.

20. Trupi Gjykses është i mendimit se i nevojitet një aktekspertizë për të qartësuar nëse gjykatat shtetërore në Kosovë ofrojnë mundësi reale për viktimat e krimeve të pretenduara të përmendura në paragrafin 2 të vendimit aktual në lidhje me kërkesat për kompensim, dhe në rast se zhdëmtimet miratohen me vendime të nxjerra nga gjykatat shtetërore në Kosovë, që ato vendime të zbatohen. Varësisht nga përfundimet e aktekspertizës, Trupi Gjykses do të duhet të vendosë lidhur me organizimin e procesit për zhdëmtim në këtë çështje gjyqësore, që siç u diskutua më sipër mund të ketë ndikim në organizimin e përgjithshëm të gjyqimit. Për këtë arsye, Trupi Gjykses ka nevojë urgjente që të marrë një aktekspertizë të tillë, me qëllim që të organizojë sa më shpejt një proces të tillë dhe që, në kohë, të marrë parashtrimet e përmendura në nenin 22(11) të Ligjit.

21. Trupi Gjykses thekson se në pajtim me rregullën 23(5) të Rregullores, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV) është njësi e Zyrës Administrative që i është besuar administrimi i sistemit të pjesëmarrjes së viktimave sikurse parashihet në nenin 22 të Ligjit, i cili u referohet si të drejtave të viktimave për pjesëmarrje në procese, po ashtu dhe për zhdëmtim.

22. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses kërkon nga ZPV-ja që deri të premtën, më 4 qershor 2021, të parashtrorë një listë me tre ekspertë përkatës, me një përmbledhje të kualifikimeve të tyre, të cilët do të mund të përgatisin një raport të tillë për Trupin Gjykses. Këta ekspertë duhet të kenë dijeni të thellë dhe/ose përvojë solide të funksionimit të sistemit juridik të Kosovës lidhur me kërkesat për kompensim të parashtruara nga viktimat e proceseve të krimeve të luftës të ngjashme me procesin aktual.

23. Mbrojtësi i të akuzuarit dhe mbrojtësja e viktimave do të ftohen që, brenda dhjetë (10) ditësh nga parashtrimi i ZPV-së, të parashtrojnë vërejtjet e tyre mbi listën e parashtruar të ekspertëve dhe të propozojnë pyetje për të cilat eksperti (ekspertët e zgjedhur përfundimisht prej Trupit Gjykes, do të japë (do të japin) përgjigje në raportin e tyre. Më tej, Trupi Gjykes do të japë udhëzime për ekspertin (ekspertët) e zgjedhur.

IV. VENDIM

24. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykes:

- a. **URDHËRON ZPV-në** të parashtrojë deri të **premtën, 4 qershor 2021**, një listë me tre ekspertë përkatës të cilët janë në dispozicion brenda një kohe të shkurtër, me qëllim që të përpilojnë aktekspertizën e përmendur në paragrafët 20 dhe 22 të vendimit aktual;
- b. **URDHËRON** mbrojtësin e të akuzuarit dhe mbrojtësen e viktimave të parashtrojnë vërejtjet e tyre, brenda dhjetë (10) ditësh nga njoftimi për parashtrim nga ZPV-ja, në përputhje me paragrafin 23 të vendimit aktual.

/nënshkrim/

Gjykatëse Mapi Veld-Folia
Kryegjykatëse

/nëshkrim/
Gjykatës Zhilber Biti

/nëshkrim/
Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 20 maj 2021
Në Hagë, Holandë.